



Local & Regional
Europe

KARTA EVROPIANE PËR BARAZI

të grave dhe burrave në jetën vendore



Këshilli i Bashkive
dhe Rajoneve Evropiane

KARTA EVROPIANE PËR BARAZI TË GRAVE DHE BURRAVE NË JETËN VENDORE

Një Kartë për organet e qeverisjes vendore dhe rajonale të Evropës,
që ato të angazhohen të përdorin kompetencat dhe partneritetet e
tyre për arritjen e një barazie më të madhe për banorët e tyre

Hartuar dhe promovuar nga
Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve Evropiane dhe partnerët e tij

Paraqitur në asamblenë e përgjithshme të KBRE-së
Insbruk, Maj 2006
Hartuar nga KBRE në kuadër të programit të pestë për veprim komunitar
për barazi të grave dhe burrave

person i kontaktit: Johanna Törnström
Johanna.tornstrom@ccre-cemr.org

info@ccre-cemr.org

Përktheu nga anglishtja: Majlinda Nishku

Ky botim u mundësua nga UN Women në kuadër të projektit
"Gender Equality Facility in Albania, Phase I",
i cili u mbështet financiarisht nga Austrian Development Cooperation (ADC)

Tiranë, 2015



[HYRJE]

Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore u drejtohet organeve të qeverisjes vendore dhe rajonale, të cilat ftohen ta nënshkruajnë, të shpallin zyrtarisht përkushtimin e tyre publik ndaj parimit të barazisë së grave dhe burrave, dhe të zbatojnë, brenda territoreve të tyre, angazhimet e parashikuara në këtë Kartë.

Për të ndihmuar në zbatimin e këtyre angazhimeve, secili autoritet nënshkruar merr përsipër të hartojë një Plan Veprimi të Barazisë, që parashtron përparësitë, veprimet dhe burimet që do të përdoren për këtë qëllim.

Përveç kësaj, secili autoritet nënshkruar merr përsipër të bashkëpunojë me të gjitha institucionet dhe organizatat në territorin e tij, me synimin për të nxitur arritjen e një barazie të vërtetë në praktikë.

Kjo Kartë u hartua në kuadrin e një projekti (2005-2006) të ndërmarrë nga Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve Evropiane, së bashku me shumë partnerë të tjerë, që janë renditur në listën e mëposhtme. Projekti u mbështet nga Komisioni Evropian përmes Programit të tij të Pestë të Veprimit Komunitar për barazi ndërmjet burrave dhe grave.

Barazia e grave dhe burrave përbën një të drejtë themelore për të gjithë dhe një vlerë thelbësore për

çdo demokraci. Për t'u arritur kjo e drejtë, duhet që ajo jo vetëm të njihet me ligj, por edhe të zbatohet me efektivitet në të gjitha sferat e jetës: politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore.

Me gjithë rastet e shumta të njohjes zyrtare dhe përparimin e bërë, barazia e grave dhe burrave në jetën e përditshme ende nuk është bërë realitet. Gratë dhe burrat nuk gëzojnë të drejta të njëjta në praktikë. Ende vazhdojnë të ekzistojnë pabarazitë shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore – për shembull, dallimet në paga dhe përfaqësimi i ulët politik.

Këto pabarazi janë rezultat i disa nocioneve shoqërore të ndërtuara mbi bazën e stereotipave të shumta të pranishme në familje, arsim, kulturë, mjetet e komunikimit, në botën e punës, në organizimin e shoqërisë... Janë aq të shumta fushat e jetës në të cilat mund të veprohet, përmes përdorimit të një qasjeje të re dhe realizimit të ndryshimeve strukturore.

Si sfera të qeverisjes që gjenden më pranë njerëzve, autoritetet vendore dhe rajonale përfaqësojnë nivelet që kanë më tepër mundësi të luftojnë vazhdimësinë dhe riprodhimin e pabarazive, si dhe të promovojnë një shoqëri me të vërtetë të barabartë. Nëpërmjet kompetencave të tyre dhe bashkëpunimit me të gjithë gamën e aktorëve vendorë, ato mund të ndërmarrin veprime konkrete në favor të barazisë së grave dhe burrave.

Për më tepër, parimi i subsidiaritetit ka një rëndësi të veçantë për sa i përket zbatimit praktik të së drejtës së barazisë së grave dhe burrave. Ky parim zbatohet për të gjitha nivelet e qeverisjes – evropiane, kombëtare, rajonale, dhe vendore. Ndonëse organet e qeverisjes vendore dhe rajonale evropiane kanë një gamë të gjerë përgjegjësish, që të gjitha mund, dhe duhet, të luajnë një rol pozitiv në nxitjen e barazisë në mënyra praktike, që ndikojnë në jetën e përditshme të popullatave të tyre.

Të lidhura ngushtë me parimin e subsidiaritetit janë edhe parimet e vetë-qeverisjes vendore dhe rajonale. Karta e Këshillit të Evropës për Vetë-Qeverisjen, e vitit 1985, e nënshkruar dhe ratifikuar nga pjesa më e madhe e shteteve evropiane, thekson *“të drejtën dhe aftësinë e autoriteteve vendore, brenda kufijve të ligjit, për të rregulluar dhe drejtuar një pjesë të konsiderueshme të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të popullatës vendore”*. Zbatimi dhe promovimi i së drejtës së barazisë duhet të qëndrojë në zemër të konceptit të vetë-qeverisjes vendore.

Demokracia vendore ose rajonale duhet të bëjë të mundur bërjen e zgjedhjeve më të përshtatshme në lidhje me aspektet më konkrete të jetës së përditshme, si strehimi, siguria, transporti publik, bota e punës dhe punësimit, ose shëndeti.

Përveç kësaj, përfshirja e plotë e grave në hartimin dhe zbatimin e politikave vendore dhe rajonale bën të mundur marrjen në konsideratë të përvojave jetësore, njohurive, dhe aftësive të tyre krijuese.

Nëse duam të arrijmë krijimin e një shoqërie të mbështetur në barazi, është thelbësore që organet e qeverisjes vendore dhe rajonale të marrin parasysh plotësisht përmasën gjinore në politikën, organizimin, dhe në praktikën e tyre të punës. Dhe, në botën e sotme dhe të nesërme, barazia e vërtetë ndërmjet grave dhe burrave është gjithashtu edhe kyçi për

suksesin tonë ekonomik dhe shoqëror – jo vetëm në nivelet evropiane dhe kombëtare, por edhe në rajonet, qytetet dhe komunitetet tona vendore.

Për vite me radhë, Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve Evropiane (KBRE) dhe komiteti i grave të zgjedhura përfaqësuese të autoriteteve vendore dhe rajonale, kanë luajtur rol aktiv për nxitjen e barazisë së grave dhe burrave në nivelet vendore dhe rajonale. Në vitin 2005, KBRE vuri në përdorim një instrument të ri konkret për autoritetet vendore dhe rajonale evropiane, i njohur me emrin *“qyteti për barazi”*. Përmes identifikimit të praktikave të mira të disa qyteteve dhe bashkive evropiane, *“qyteti për barazi”* ofron një metodologji për zbatimin e politikave për barazi të burrave dhe grave në nivel vendor dhe rajonal. Kjo Kartë mbështetet në këtë përvojë.

Roli i organeve të qeverisjes vendore dhe rajonale për promovimin e barazisë gjinore u konfirmua në Deklaratën Mbarëbotërore të Bashkimit Ndërkombëtar të Autoriteteve Vendore (në anglishte International Union of Local Authorities) për *“gratë në qeverisjen vendore”*, miratuar në vitin 1998. Organizata e re botërore, Qytetet e Bashkuara dhe Organet e Qeverisjes Vendore (United Cities and Local Governments), ka barazinë e grave dhe burrave si një prej objektivave të saj kryesore.

[PARATHËNIE]

Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve Evropiane, që përfaqëson organet e qeverisjes vendore dhe rajonale evropiane, në bashkëpunim me partnerët e mëposhtëm:

Shoqata Kombëtare e Bashkive në Republikën e Bullgarisë (NAMRB)

Bashkimi i Bashkive të Qipros (UCM)

Bashkimi i Qyteteve dhe Komuniteteve të Republikës Çeke (SMO CR)

Shoqata e Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Finlandës (AFLRA)

Seksioni Francez i KBRE (AFCCRE)

Seksioni Gjerman i KBRE (RGRE)

Bashkimi Qendror i Bashkive dhe Komuniteteve të Greqisë (KEDKE)

Shoqata Kombëtare Hungareze e Autoriteteve Vendore (TOOSZ)

Seksioni italian i CEMR (AICCRE)

Federata toskane e AICCRE

Shoqata e Qyteteve dhe Bashkive të Luksemburgut (SYVICOL)

Shoqata e Qyteteve Polake (ZMP)

Federata Spanjolle e Bashkive dhe Krahinave (FEMP)

Shoqata Baske e Bashkive (EUDEL)

Qyteti i Vjenës (Austri)

Qyteti Saint Jean de la Rouelle (Francë)

Qyteti i Frankfurt am Main (Gjermani)

Qyteti i Kartagenës (Spanjë)

Qyteti i Valencias (Spanjë)

Ndërtesa e Kohës dhe Lëvizshmërisë Belfort-Montbeliard (Francë)

Komiteti i Përhershëm i Partneritetit Euro-Mesdhetar të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale (COPPEM)

Duke pasur parasysh se Komuniteti dhe Bashkimi Evropian janë themeluar mbi bazat e të drejtave dhe lirive themelore, ndër të cilat edhe promovimi i barazisë së grave dhe burrave dhe se legjislacioni evropian ka qenë bazë për përparimet e arritura në këtë fushë në Evropë;

Duke pasur parasysh kuadrin ligjor ndërkombëtar i të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuara, dhe

sidomos Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, miratuar në vitin 1979;

Duke theksuar kontributin thelbësor të Këshillit të Evropës për promovimin e barazisë së grave dhe burrave dhe të vetëqeverisjes vendore;

Duke qenë të mendimit se barazia e grave dhe burrave nënkupton vullnetin për të ndërmarrë veprime në tre aspektet plotësuese për arritjen e saj, konkretisht: eliminimin e pabarazive të drejtpërdrejta, çrënjosjen e pabarazive jo të drejtpërdrejta, dhe ndërtimin e një mjedisi politik, ligjor dhe shoqëror që mbështet zhvillimin proaktiv të një demokracie egalitare;

Duke shprehur keqardhjen e thellë për vazhdimin e mospërputhjeve ndërmjet njohjes de jure të së drejtës për barazi dhe zbatimit të vërtetë dhe efektiv të saj në praktikë;

Duke qenë të mendimit se në Evropë, organet e qeverisjes vendore dhe rajonale luajnë, dhe duhet të luajnë, një rol kyç për qytetarët dhe banorët e tyre, për zbatimin e të drejtës për barazi, sidomos të grave dhe burrave, në të gjitha fushat e tyre të përgjegjësisë;

Duke qenë të mendimit se pjesëmarrja dhe përfaqësimi i balancuar i grave dhe burrave në vendimmarrje dhe në poste drejtuese është me rëndësi thelbësore për demokracinë;

Duke marrë frymëzim për veprimet tona në veçanti nga Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, e vitit 1979, Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim e Kombeve të Bashkuara të vitit 1995, dhe Rezolutat e Seancës së 23-të të Posaçme të Asamblesë së Përgjithshme të vitit 2000 (Pekin +5), Karta e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, Rekomandimi i Këshillit të dhjetorit 1996 për pjesëmarrjen e balancuar të

grave dhe burrave në proceset e vendimmarrjes, dhe Deklarata Mbarëbotërore e Bashkimit Ndërkombëtar të Autoriteteve Vendore për gratë në qeverisjen vendore, e vitit 1998;

Duke dëshiruar të shënojnë përvjetorin e njëzetepeshtë të hyrjes në fuqi të Konventës së Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, e shtatorit të vitit 1981;

ka hartuar këtë Kartë Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, dhe ftojnë organet e qeverisjes vendore dhe rajonale të Evropës ta nënshkruajnë dhe ta zbatojnë këtë Kartë.

[PJESA I]

Parimet

Palët Nënshkruese të kësaj Karte Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore njohin sa vijon si parime themelore në veprimet tona:

1. Barazia e grave dhe burrave përbën një të drejtë themelore

Kjo e drejtë duhet të zbatohet nga organet e qeverisjes vendore dhe rajonale në të gjitha fushat e tyre të përgjegjësisë, ndër të cilat edhe detyrimin e tyre për të eliminuar të gjitha format e diskriminimit, qofshin të drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta.

2. Për të siguruar barazinë ndërmjet grave dhe burrave, duhet të trajtohen çështjet e diskriminimit dhe të pengesave

Në trajtimin e barazisë së grave dhe burrave, duhet të merren parasysh çështje si diskriminimi dhe pengesat e shumëfishta, që bazohen, përveç gjinisë, edhe tek raca, ngjyra, origjina etnike dhe shoqërore, tiparet gjenetike, gjuha, feja dhe besimi, opinionet politike dhe çfarëdo opinion tjetër, prona, origjina e lindjes, aftësia e kufizuar, mosha, orientimi seksual ose gjendja social-ekonomike.

3. Pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave në vendimmarrje është parakusht për një shoqëri demokratike

E drejta për barazi të grave dhe burrave kërkon që organet qeverisëse vendore dhe rajonale të marrin të gjitha masat e duhura dhe të miratojnë të gjitha strategjitë e përshtatshme për promovimin e një përfaqësimi dhe pjesëmarrjeje të balancuar të grave dhe burrave në të gjitha sferat e vendimmarrjes.

4. Eliminimi i stereotipave gjinore ka rëndësi themelore për arritjen e barazisë së burrave dhe grave

Autoritetet vendore dhe rajonale duhet të nxisin eliminimin e stereotipave dhe pengesave mbi të cilat mbështeten pabarazitë në statusin dhe gjendjen e grave, dhe që shkaktojnë një vlerësim jo të barabartë të roleve të grave dhe burrave në terma politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore.

5. Integrimi i këndvështrimit gjinor në të gjitha veprimtaritë e organeve të qeverisjes vendore dhe rajonale është i nevojshëm për të çuar përpara barazinë e grave dhe burrave

Këndvështrimi gjinor duhet të mbahet parasysh në hartimin e politikave, metodave dhe instrumenteve që ndikojnë në jetën e përditshme të popullatave vendore – për shembull, përmes përdorimit të teknikave të “përfshirjes së perspektivës gjinore”¹ dhe “buxhetimit

¹ Përfshirja e perspektivës gjinore: Në korrik të vitit 1997, Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara (ECOSOC) e përkufizoi konceptin e

gjinor.”² Për arritjen e këtij synimi, duhet të analizohen dhe të merren parasysh përvojat e grave në jetën vendore, përfshirë edhe kushtet e tyre të jetesës dhe të punës.

6. Plane dhe programe veprimit, të mbështetura me burimet e duhura, janë instrumente të nevojshme për çuarjen përpara të barazisë së burrave dhe grave

Organet e qeverisjes vendore dhe rajonale duhet të hartojnë plane dhe programe veprimi për barazinë, së bashku me mjetet dhe burimet financiare e njerëzore të nevojshme për zbatimin e tyre.

Këto parime përbëjnë themelet e Neneve të parashtruara në Pjesën III në vijim

përfshirjes së perspektivës gjinore si vijon: “Përfshirja e perspektivës gjinore është procesi i vlerësimit të rrjedhëve që ka për gratë dhe burrat çdo veprim i planifikuar, ku përfshihen legjislacioni, politikat dhe programet, në çfarëdo fushe dhe në të gjitha nivelet. Ajo është një strategji për t’i bërë shqetësimet dhe përvojat e grave pjesë përbërëse të hartimit, zbatimit, mbikëqyrjes dhe vlerësimit të politikave dhe programeve në të gjitha sferat politike, ekonomike dhe të shoqërisë, në mënyrë që burrat dhe gratë të përfitojnë në mënyrë të barabartë, dhe që të ndërpritet vijimi i pabarazisë. Synimi përfundimtar i përfshirjes gjinore është arritja e barazisë gjinore”.

2 **Buxhetimi Gjinor:** “Buxhetimi gjinor është zbatimi i përfshirjes së perspektivës gjinore në proceset e hartimit të buxhetiit. Ai do të thotë vlerësim me bazë gjinore i buxheteve, përfshirje e këndvështrimit gjinor në të gjitha nivelet e procesit buxhetor dhe ristrukturim i të ardhurave dhe shpenzimeve me qëllim promovimin e barazisë gjinore.”

[PJESA II]

Zbatimi i kartës dhe i angazhimeve që rrjedhin prej saj

Pala Nënshkruese merr përsipër të ndërmarrë hapat e mëposhtme konkrete me qëllim zbatimin e dispozitave të kësaj Karte:

- (1) Çdo Palë Nënshkruese e kësaj Karte, brenda një afati kohor të arsyeshëm (që nuk duhet të jetë më shumë se 2 vjet) pas datës së nënshkrimit, duhet të hartojë dhe miratojë Planin e saj të Barazisë Gjimore, dhe ta zbatojë atë në vijimësi.
- (2) Plani i Veprimit për Barazinë duhet të përcaktojë objektivat dhe përparësitë e Palës Nënshkruese, masat që planifikon të marrë, dhe burimet që do të caktojë, me qëllim vënien në jetë të Kartës dhe të angazhimeve të parashikuara në të. Ky Plan do të përshkruajë gjithashtu edhe afatet kohore të propozuara për zbatim. Në rastet kur Pala Nënshkruese e ka tashmë të hartuar Planin e Veprimit për Barazi, ajo do ta rishqyrtojë atë Plan për të siguruar se ai i trajton të gjitha çështjet që lidhen me këtë Karte.
- (3) Çdo Palë Nënshkruese do të bëjë konsultime të gjera përpara se sa ta miratojë Planin e Veprimit për Barazi, si dhe do ta shpërndajë Planin gjerësisht pas miratimit. Gjithashtu, ajo do të raportojë rregullisht në publik për përparimin e bërë në zbatimin e Planit.
- (4) Çdo Palë Nënshkruese do ta rishikojë Planin e saj të Veprimit për Barazi siç do ta kërkojnë rrethanat, si dhe do të hartojë një Plan të mëtejshëm për çdo periudhë vijuese.
- (5) Çdo Palë Nënshkruese merr përsipër në parim të bashkëpunojë për krijimin dhe përdorimin e një sistemi të përshtatshëm vlerësimi, që do të bëjë të mundur vlerësimin e përparimit në zbatimin e kësaj Karte, si dhe do të ndihmojë që organet e qeverisjes vendore dhe rajonale në të gjithë Evropën të mësojnë nga njëri-tjetri për mjetet më të frytshme të realizimit të një barazie më të madhe të grave dhe burrave. Për këto qëllime, ajo do të verë në dispozicion Planin e Veprimit për Barazi si dhe materiale të tjera publike që lidhen me të.
- (6) Çdo Palë Nënshkruese do ta njoftojë me shkrim Këshillin e Bashkive dhe Rajoneve Evropiane për faktin se e ka nënshkruar këtë Kartë, datën e këtij nënshkrimi, së bashku me të dhënat e një pike kontakti për bashkëpunim të mëtejshëm në kuadrin e kësaj Karte.

PJESA III

Llogaridhënia demokratike

Neni 1

- (1) Pala Nënshkruese pranon se e drejta për barazi të grave dhe burrave është parakusht themelor për demokracinë dhe se shoqëria demokratike dëmtohet nëse shpërfill aftësitë, njohuritë, përvojat dhe aftësitë krijuese të grave. Për këtë qëllim, ajo duhet të sigurojë, mbi baza të barazisë, përfshirjen, përfaqësimin dhe angazhimin e grave me prejardhje dhe nga grupmosha të ndryshme, në të gjitha sferat e vendimmarrjes politike dhe publike.
- (2) Pala Nënshkruese, si organi përgjegjës për promovimin e mirëqenies së popullatës dhe zonës së saj i zgjedhur në mënyrë demokratike, merr përsipër si rezultat të promovojë dhe çojë përpara zbatimin praktik të kësaj të drejte në të gjitha sferat e veprimtarisë së saj – si udhëheqëse demokratike e komunitetit vendor, ofruese dhe porositëse e shërbimeve, planifikuese dhe ligjvënëse, dhe si punëdhënëse.

Roli politik

Neni 2 – Përfaqësimi politik

- (1) Pala Nënshkruese njeh të drejtat e barabarta të grave dhe burrave për të votuar, për të kandiduar dhe për të mbajtur një post të zgjedhur.
- (2) Pala Nënshkruese njeh të drejtat e barabarta të grave dhe burrave për të marrë pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave, për të mbajtur poste publike dhe për të kryer të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisjes.
- (3) Pala Nënshkruese njeh parimin e përfaqësimit të balancuar në të gjitha organet e zgjedhura dhe publike vendimmarrëse.
- (4) Pala Nënshkruese angazhohet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme në mbështetje të të drejtave dhe parimit të mësipërm, ndër të cilat:
 - Të nxisë gratë të regjistrohen për të votuar, të ushtrojnë të drejtat e tyre individuale të votës dhe të venë kandidaturën për poste publike
 - Të nxisë partitë dhe grupet politike të miratojnë dhe zbatojnë parimin e përfaqësimit të barabartë të grave dhe burrave
 - Për arritjen e këtij qëllimi, të nxisë partitë dhe grupet politike të ndërmarrin të gjitha hapat e

ligjshme, përfshirë edhe miratimin e kuotave aty ku mendohet se është e përshtatshme, për të rritur numrin e grave të emëruara si kandidatë dhe atyre të zgjedhura

- Të nxjerrë rregullore për procedurat dhe standardet e sjelljes së vet, në mënyrë që gratë kandidatë të mundshme si dhe përfaqësueset e zgjedhura të mos shkurajohen për shkak të formave stereotipe të sjelljes dhe gjuhës, apo nga ngacmimet

- Të miratojë masa për të bërë të mundur që përfaqësuesit dhe përfaqësueset e zgjedhura të kenë mundësi të pajtojnë jetën e tyre private, profesionale, dhe publike; për shembull duke marrë masa që oraret, metodat e punës dhe ofrimi i shërbimeve të përkujdesit për anëtarët e familjes në varësi të tyre, të bëjnë të mundur një pjesëmarrje të plotë të të gjithë përfaqësuesve të zgjedhur.

(5) Pala Nënshkruese angazhohet të promovojë dhe zbatojë parimin e përfaqësimit të balancuar në organet e veta vendimmarrëse dhe konsultative, si dhe në emërimet që bën në organe të tjera të jashtme.

Megjithatë, në rastet kur në autoritetin vendor përkatës nuk ka një përfaqësim të balancuar të grave dhe burrave, ky autoritet duhet ta zbatojë parimin e mësipërm mbi baza jo më pak të favorshme për gjininë pakicë se sa balanca ekzistuese gjinore në të.

(6) Përveç kësaj, Pala Nënshkruese angazhohet të sigurojë që asnjë post publik dhe politik ku ajo emëron apo zgjedh përfaqësues nuk do të kufizohet dhe nuk do të shihet, as në parim e as në praktikë, si roli i zakonshëm i një gjinie si pasojë e qëndrimeve stereotipe.

Neni 3 – Pjesëmarrja në jetën politike dhe qytetare

(1) Pala Nënshkruese njeh se e drejta e qytetarëve për të marrë pjesë në kryerjen e punëve publike është një parim themelor demokratik dhe se gratë e burrat kanë të drejtë të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në qeverisjen dhe jetën publike të rajonit, bashkisë, dhe komunitetit të tyre vendor.

(2) Në lidhje me format e ndryshme të pjesëmarrjes publike në punët e saj, si për shembull përmes komiteteve këshilluese, këshillave të lagjeve, pjesëmarrjes elektronike apo praktikave të planifikimit me pjesëmarrje, Pala Nënshkruese angazhohet të sigurojë se gratë dhe burrat do të jenë në gjendje të kenë pjesëmarrje të barabartë në praktikë. Në ato raste kur mjetet ekzistuese të pjesëmarrjes nuk çojnë në një barazi të tillë, ajo merr përsipër të krijojë dhe të provojë metoda të reja.

(3) Pala Nënshkruese merr përsipër të promovojë pjesëmarrjen aktive në jetën politike dhe qytetare të grave dhe burrave nga të gjitha seksionet e komunitetit, sidomos të grave dhe burrave nga grupet e pakicave që përndryshe mund të mbeten të përjashtuar.

Neni 4 - Angazhimi publik për barazi

(1) Pala Nënshkruese, si udhëheqëse demokratike dhe përfaqësuese e komunitetit dhe territorit të vet, duhet të ndërmarrë një angazhim publik zyrtar ndaj parimit të barazisë së grave dhe burrave në jetën publike, ku përfshihen:

- Shpallja publike të nënshkrimit të kësaj Karte nga Pala Nënshkruese, pas debatimit dhe miratimit të Kartës nga organi më i lartë përfaqësues i saj;
- Zotimi për të përmbushur angazhimet e saj në kuadrin e kësaj Karte, dhe për të raportuar publikisht, dhe rregullisht, për përparimin e bërë në zbatimin e Planit të saj të Veprimit për Barazi;

• Një zotim se Pala Nënshkruese dhe anëtarët e zgjedhur të saj, do t'i përmbahen dhe do të kenë standarde të mira të sjelljes në lidhje me barazinë gjinore.

(2) Pala Nënshkruese do të përdorë mandatin e saj demokratik për të nxitur institucionet e tjera publike dhe politike si dhe entet private dhe organizatat e shoqërisë civile, që të ndërmarrin veprime për të siguruar në praktikë të drejtën e barazisë së grave dhe burrave.

Neni 5 – Puna me partnerët për promovimin e barazisë

(1) Pala Nënshkruese merr përsipër të bashkëpunojë me të gjithë partnerët e saj nga sektorët publikë dhe privatë, si dhe me organizatat e shoqërisë civile, me qëllim që të promovohet një barazi më e madhe e grave dhe burrave në të gjitha aspektet e jetës brenda territorit të saj. Ajo do të përpikët në veçanti që të bashkëpunojë me partnerët e saj socialë për këtë qëllim.

(2) Pala Nënshkruese do të zhvillojë konsultime me organet dhe organizatat e saj partnere, përfshirë partnerët e saj socialë, për hartimin dhe rishikimin e Planeve të saj të Veprimit për Barazi, si dhe për çështje të tjera madhore që lidhen me barazinë.

Neni 6 – Lufta kundër stereotipave

(1) Pala Nënshkruese angazhohet të luftojë dhe, aq sa është e mundur, të parandalojë paragjykimet, praktikat, dhe përdorimin e gjuhës dhe pamjeve që mbështeten në idenë e superioritetit apo inferioritetit të secilit prej sekseve, ose për rolet e stereotipizuara të grave dhe burrave.

(2) Për këtë qëllim, Pala Nënshkruese do të sigurojë që komunikimet e saj publike dhe të brendshme të jenë në përputhje të plotë me këtë angazhim, dhe të promovojnë imazhe dhe shembuj gjinorë pozitivë.

(3) Pala Nënshkruese gjithashtu do të ndihmojë punonjësit e saj, përmes trajnimeve dhe mjeteve të tjera, që të identifikojnë dhe eliminojnë qëndrimet dhe sjelljet stereotipike, dhe do të vendosë rregulla për standardet e sjelljes në këtë drejtim.

(4) Pala Nënshkruese do të zhvillojë veprimtari dhe fushata për ngritjen e ndërgjegjësimit për rolin e dëmshëm të stereotipave gjinore në arritjen e barazisë së burrave dhe grave.

Neni 7 – Mirë-administrimi dhe konsultimi

(1) Pala Nënshkruese njeh të drejtën e grave dhe burrave që çështjet e tyre të trajtohen në mënyrë të barabartë, të paanshme, të drejtë, dhe brenda një kohe të arsyeshme, ku përfshihen:

• E drejta e banorëve për t'u dëgjuar përpara marrjes së çfarëdo vendimi individual që mund të ndikojë negativisht tek ta;

• Detyrimi i autoritetit për të dhënë arsyet e marrjes së vendimeve të tij;

• E drejta për marrjen e informacioneve përkatëse për çështjet që ndikojnë tek ta.

(2) Pala Nënshkruese pranon se, në të gjithë gamën e kompetencave të veta, cilësia e politikave dhe vendimmarrjeve të saj ka gjasa të rritet më tej nëse të gjithë personat e ndikuar prej tyre do të kenë mundësinë të konsultohen në fazën formuese, dhe se është me rëndësi thelbësore që grave dhe burrave t'u jepet në praktikë qasje e barabartë në informacionet përkatëse dhe mundësi të barabartë për të reaguar.

(3) Pala Nënshkruese, si rrjedhojë, angazhohet të ndërmarrë hapat e mëposhtëm, si të jetë e përshtatshme:

- Të sigurojë që praktikatat për dhënien e informacionit të marrin parasysh nevojat e grave dhe burrave, përfshirë edhe qasjen e tyre përkatëse në informacion dhe në teknologjitë e komunikimit;
- Të sigurojë që, në rastet kur bëhen konsultime, ata persona pikëpamjet e të cilëve përndryshe do të kishte më pak gjasa të dëgjoheshin, të jenë në gjendje të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në procesin e konsultimit, dhe të ndërmarrë veprime pozitive të ligjshme për të siguruar realizimin e kësaj;
- Të kryejë, aty ku është e përshtatshme, veprimtari të veçanta konsultuese për gratë.

Kuadri i përgjithshëm i barazisë

Neni 8 – Angazhimi i përgjithshëm

- (1) Pala Nënshkruese, në bazë të të gjitha kompetencave të saj, do të njohë, respektojë dhe nxisë të drejtat dhe parimet përkatëse të barazisë së burrave dhe grave dhe do të luftojë disavantazhin dhe diskriminimin që lidhet me gjininë.
- (2) Angazhimet e përcaktuara në këtë Kartë zbatohen nga Pala Nënshkruese vetëm kur këto angazhime, ose aspekte relevante të tyre, janë brenda kuadrit të kompetencave ligjore të Palës Nënshkruese.

Neni 9 – Vlerësimi gjinor

- (1) Pala Nënshkruese ndërmerr, në lidhje me çdo sektor të kompetencave të saj, një vlerësim gjinor, ashtu siç është përcaktuar në këtë nen.
- (2) Për këtë qëllim, Pala Nënshkruese merr përsipër të hartojë një program për zbatimin e vlerësimeve të saj gjinore, në përputhje me përparësitë, burimet dhe afatet e veta, që do të përfshihet apo do të merret parasysh në Planin e saj të Veprimit për Barazi.
- (3) Vlerësimet gjinore do të përfshijnë, sipas rastit përkatës, hapat e mëposhtme:
 - Rishikimin e politikave, procedurave, praktikave dhe modeleve e vëllimeve të përdorimit, me qëllim që të vlerësohet nëse ato shfaqin ndonjë diskriminim të padrejtë, nëse janë bazuar në stereotipa gjinore, dhe nëse marrin parasysh në mënyrë të përshtatshme nevojat e veçanta që mund të kenë gratë dhe burrat;

- Rishikimin e caktimit të burimeve, financiare apo të tjera, për qëllimet e mësipërme;
- Identifikimin e përparësive, dhe aty ku është e përshtatshme, të objektivave, me qëllim që të trajtohen dhe zgjidhen çështjet përkatëse që dalin nga këto rishikime, si dhe për të sjellë përmirësime të identifikueshme në ofrimin e shërbimeve;
- Kryerjen, në një fazë të hershme, të një vlerësimi të të gjitha propozimeve të rëndësishme për politika, procedura dhe ndryshime të reja apo të amenduara në caktimin e burimeve, për të identifikuar ndikimin e tyre të mundshëm tek gratë dhe burrat, dhe për të marrë vendime përfundimtare nën dritën e këtyre vlerësimeve.
- Marrjen parasysh të nevojave ose interesave të atyre që përjetojnë diskriminim apo disavantazh të shumëfishtë.

Neni 10 – Diskriminimi ose disavantazhi i shumëfishtë

- (1) Pala Nënshkruese pranon se diskriminimi mbi çfarëdo bazash, si seksi, raca, origjina etnike ose shoqërore, tiparet gjenetike, gjuha, feja ose besimi, pikëpamjet politike ose opinione të tjera, anëtarësia në një pakicë kombëtare, prona, origjina në lindje, aftësia e kufizuar, mosha apo orientimi seksual, është i ndaluar.
- (2) Pala Nënshkruese më tej pranon se, pavarësisht nga ky ndalim, shumë gra dhe burra vuajnë nga diskriminimi ose disavantazhi i shumëfishtë, përfshirë edhe disavantazhin social-ekonomik, që ndikon drejtpërsëdrejti në aftësinë e tyre për të ushtruar të drejtat e tjera të parashikuara dhe të përmendura në këtë Kartë.

- (3) Pala Nënshkruese angazhohet, në të gjithë gamën e kompetencave të saj, të ndërmarrë të gjitha veprimet e arsyeshme për të luftuar ndikimin e diskriminimit apo disavantazhit të shumëfishtë, ku përfshihen:

- Të sigurojë që çështjet e diskriminimit dhe disavantazhit të shumëfishtë të trajtohen në Planin e saj të Veprimit për Barazi dhe vlerësimet gjinore;
- Të sigurojë që çështjet që rrjedhin nga diskriminimi dhe disavantazhi i shumëfishtë të merren parasysh kur ndërmerren veprime apo masa në bazë të neneve të tjera në këtë Kartë;
- Të ndërmarrë fushata të informimit publik për të luftuar stereotipet dhe për të promovuar trajtim të barabartë për gratë e burrat që mund të vuajnë nga diskriminimi apo disavantazhi i shumëfishtë;
- Të marrë masa të posaçme për të trajtuar nevojat e veçanta të grave dhe burrave migrantë.

Roli punëdhënës

Neni 11

(1) Pala Nënshkruese, në kuadër të rolit të saj si punëdhënëse, njeh të drejtën për barazi të burrave dhe grave në lidhje me të gjitha aspektet e punësimit, përfshirë organizimin e punës dhe kushtet e punës.

(2) Pala Nënshkruese njeh të drejtën e harmonizimit të jetës profesionale, shoqërore dhe private dhe të drejtën për dinjitet dhe siguri në vendin e punës.

(3) Pala Nënshkruese angazhohet të marrë të gjitha masat e arsyeshme, përfshirë dhe veprime afirmative brenda kompetencave të veta, në mbështetje të të drejtave të mësipërme.

(4) Masat e përmendura në (3) përfshijnë sa më poshtë:

(a) Një rishikim të politikave dhe procedurave përkatëse që lidhen me punësimin brenda organizatës së saj, dhe hartimin dhe zbatimin e pjesës së punësimit të Planit të Veprimit për Barazi për të trajtuar pabarazitë brenda një periudhe të arsyeshme kohe ndër të cilat:

- Paga të barabarta, përfshirë pagën e barabartë për punë me vlerë të barabartë;

- Masa për të siguruar ngritje në detyrë dhe mundësi të drejta e transparente për zhvillim në karrierë;

- Masa për të siguruar një përfaqësim të balancuar të grave dhe burrave në të gjitha nivelet, në veçanti për të trajtuar çdo lloj mungese balance në nivelet drejtuese;

- Masa për të trajtuar çdo segregim me bazë seksin në punë, dhe për të nxitur punëdhënësit të ndërmarrin punësime jo tradicionale

- Masa për të siguruar praktika të drejta rekrutimi në punë;

- Masa për të siguruar kushte të përshtatshme, të shëndetshme dhe të sigurta pune;

- Procedura për konsultime me punonjësit dhe organizatat e tyre profesionale, duke siguruar pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave në çdo organ konsultues ose negociator.

(b) Luftimi i ngacimit seksual në vendin e punës duke bërë deklarata të qarta se sjellje të tilla janë të papranueshme, duke mbështetur viktimat, duke përdorur dhe zbatuar politika transparente për të trajtuar autorët e ngacimeve, dhe duke ngritur ndërgjegjësimin për këtë çështje;

(c) Kalimi, në të gjitha nivelet e organizatës, drejt një force punonjëse që pasqyron shumëllojshmërinë shoqërore, ekonomike dhe kulturore të popullatës së tyre vendore;

(d) Mbështetja e pajtueshmërisë ndërmjet jetës profesionale, shoqërore dhe private, përmes:

- Vendosi të politikave që lejojnë, aty ku është e mundur, përshtatje të orareve të punës dhe organizim të përkujdesit për familjarët në varësi të punonjësve;

- Nxitjes së burrave që ta përdorin të drejtën e tyre për të marrë leje nga puna për t'u përkujdesur për familjarët në varësi të tyre.

Prokurimet dhe kontratat publike

Neni 12

(1) Pala Nënshkruese pranon se, në kryerjen e detyrave dhe detyrimeve të saj në lidhje me prokurimet publike, përfshirë kontratat për furnizimin me mallra, ofrimin e shërbimeve, ose ekzekutimin e punimeve, ajo ka përgjegjësi të promovojë barazinë e burrave dhe grave.

(2) Pala Nënshkruese pranon se kjo përgjegjësi ka rëndësi të veçantë në rastet kur ajo propozon të lidhë kontratë të jashtme me një subjekt tjetër ligjor për ofrimin e një shërbimi të rëndësishëm për publikun, për të cilin sipas ligjit është përgjegjëse Pala Nënshkruese. Në raste të tilla, Pala Nënshkruese do të sigurojë që njësia ligjore që do të fitojë kontratën (e çfarëdo lloji qoftë forma e pronësisë së saj) do të ketë të njëjtat përgjegjësi për sigurimin dhe promovimin e barazisë e grave dhe burrave, njëlloj siç do ta kishte Pala Nënshkruese në qoftë se do ta ofronte shërbimin drejtpërsëdrejti vetë.

(3) Më tej, Pala Nënshkruese angazhohet të zbatojë, sa herë që e konsideron të përshtatshme, hapat e mëposhtëm:

(a) Për çdo kontratë të rëndësishme që propozon të lidhë, të marrë në shqyrtim rrjedhojat përkatëse gjinore dhe mundësitë për të promovuar barazinë brenda ligjit;

(b) Të sigurojë që specifikimet kontraktuale të mbajnë parasysh objektivat e barazisë gjinore të kontratës;

(c) Të sigurojë që kushtet dhe termat e tjera

kontraktuale të kontratës të mbajnë parasysh dhe të pasqyrojnë këto objektiva;

(d) Të përdorë kompetencat sipas legjislacionit të prokurimit publik të Bashkimit Evropian për të përcaktuar kushte performance që kanë të bëjnë me konsiderata sociale;

(e) T'i ndërgjegjësojë punonjësit ose këshilltarët e saj përgjegjës për detyrat e prokurimit publik dhe dhënien e kontratave, për përmasën e barazisë gjinore në punën e tyre, përfshirë edhe përmes trajnimeve për këtë qëllim;

(f) Të sigurojë që termat e një kontrate kryesore të përfshijnë edhe kërkesën që edhe nënkontraktuesit duhet t'i përmbahen detyrimeve përkatëse për promovimin e barazisë gjinore.

Roli i ofrimit të shërbimeve

Neni 13 – Arsimi dhe të nxëniet gjatë gjithë jetës

- (1) Pala Nënshkruese njih të drejtën e çdokujt për t'u arsimuar, dhe përveç kësaj njih edhe të drejtën e qasjes në të gjitha formimet profesionale dhe të arsimit të mëtejshëm. Pala Nënshkruese njih rolin jetësor të arsimit në të gjitha fazat e jetës për sigurimin e një barazie të vërtetë mundësisht, dhënien e aftësive thelbësore për jetë dhe punësim, dhe krijimin e mundësive të reja për zhvillim profesional.
- (2) Pala Nënshkruese merr përsipër, brenda gamës së kompetencave të saj, të sigurojë ose promovojë qasje të barabartë në arsim dhe në formim profesional dhe të mëtejshëm për gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë.
- (3) Pala Nënshkruese njih nevojën për të eliminuar çfarëdo koncepti stereotip të roleve të grave dhe burrave në të gjitha format e arsimit. Për ta bërë këtë, ajo merr përsipër të zhvillojë ose promovojë, sipas rastit, masat e mëposhtme:
 - Rishikimin e materialeve arsimore të programeve shkollore dhe programeve të tjera arsimore, si dhe të metodave të mësimdhënies, për të siguruar që ato të luftojnë qëndrimet dhe praktikat stereotipe.
 - Ndërmarrjen e veprimeve specifike për të nxitur zgjedhje karriere jotradicionale
 - Përfshirjen e posaçme, në lëndët e edukatës qytetare dhe qytetarisë, të elementëve që theksojnë rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë të burrave dhe grave në proceset demokratike.

- (4) Pala Nënshkruese pranon se mënyrat se si qeverisen shkollat dhe institucionet e tjera arsimore përfaqësojnë shembuj të rëndësishëm model për fëmijët dhe të rinjtë. Për këtë arsye, ajo merr përsipër të promovojë përfaqësim të balancuar të grave dhe burrave në të gjitha nivelet e drejtimit dhe të qeverisjes së shkollave.

Neni 14 – Shëndeti

- (1) Pala Nënshkruese pranon të drejtën e çdokujt për të gëzuar shëndet mendor dhe fizik të një standardi të lartë, dhe thekson se qasja në një shërbim shëndetësor dhe trajtim mjekësor me cilësi të mirë, si dhe në shërbimet e kujdesit parandalues për gratë dhe burrat është me rëndësi thelbësore për realizimin e kësaj të drejte.
- (2) Pala Nënshkruese pranon se, duke siguruar mundësi të barabarta që gratë dhe burrat të gëzojnë shëndet të mirë, shërbimet mjekësore dhe shëndetësore duhet të mbajnë parasysh nevojat e tyre të ndryshme. Ajo e pranon gjithashtu se këto nevoja nuk rrjedhin vetëm si rezultat i dallimeve biologjike, por edhe nga dallimet në kushtet e jetesës dhe të punës dhe nga qëndrimet dhe hipotezat e bazuara në stereotipe.
- (3) Pala Nënshkruese merr përsipër të marrë të gjitha veprimet e arsyeshme, brenda gamës së kompetencave të saj, për të promovuar dhe siguruar nivelet më të larta të shëndetit të mirë të qytetarëve të saj. Për këtë qëllim, Pala Nënshkruese merr përsipër të zhvillojë ose promovojë, sipas rastit, masat e mëposhtme:
 - Të përfshijë një qasje me bazë gjinore në planifikimin, caktimin e burimeve dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe mjekësore

- Të sigurojë që veprimtaritë për promovimin e shëndetit, përfshirë edhe ato që nxisin një të ushqyer të shëndetshëm dhe rëndësinë e ushtrimeve fizike, të përfshijnë njohjen e nevojave dhe qëndrimeve të veçanta të grave dhe burrave
- Të sigurojë që punonjësit e shëndetësisë, përfshirë dhe ata që merren me promovimin e shëndetit, të njohin mënyrat se si ndikon gjinia në shërbimin shëndetësor dhe mjekësor, dhe të mbajnë parasysh përvojat e ndryshme të grave dhe burrave me këto shërbime
- Të sigurojë që gratë dhe burrat të kenë qasje të përshtatshme në informacione shëndetësore.

Neni 15 – Përkujdesi dhe shërbimet sociale

- (1) Pala Nënshkruese pranon se çdokush ka të drejtën e shërbimeve të nevojshme sociale dhe të përfitojë nga ndihma sociale në rast nevojë.
- (2) Pala Nënshkruese pranon se gratë dhe burrat kanë nevoja të ndryshme që mund të rrjedhin nga dallimet në kushtet e tyre shoqërore dhe ekonomike dhe nga faktorë të tjerë. Për këtë arsye, për të siguruar që gratë dhe burrat të kenë qasje të barabartë në shërbimet dhe përkujdesin social, Pala Nënshkruese do të marrë të gjitha masat e nevojshme që:

- Të përfshijë një qasje me bazë gjinore në planifikimin, caktimin e burimeve dhe ofrimin e shërbimit social dhe përkujdesit social
- Të sigurojë që personat e përfshirë në ofrimin e shërbimeve sociale dhe kujdesit social i njohin mënyrat se si ndikon gjinia në këto shërbime dhe mbajnë parasysh përvojat e ndryshme të grave dhe burrave me atë përkujdes.

Neni 16 – Kujdesi për fëmijët

- (1) Pala Nënshkruese njeh rolin thelbësor që luan një shërbim cilësor, i përballueshëm financiarisht, dhe i hapur për të gjithë prindërit dhe kujdestarët, pavarësisht nga gjendja e tyre, për të promovuar një barazi të vërtetë ndërmjet grave dhe burrave, dhe për t'u mundësuar atyre të harmonizojnë jetët e tyre profesionale, publike dhe private. Përveç kësaj Pala Nënshkruese njeh kontributin që jep ky lloj kujdesi për fëmijët në jetën ekonomike dhe shoqërore dhe në përbërjen e shëndoshë të komunitetit vendor, si dhe të shoqërisë në përgjithësi.
- (2) Pala Nënshkruese angazhohet ta bëjë ofrimin dhe promovimin e këtij kujdesi për fëmijët, drejtpërsëdrejti ose përmes ofruesve të tjerë, një nga përparësitë e saj. Më tej, ajo angazhohet të nxisë ofrimin e shërbimeve të tilla të kujdesit për fëmijët nga të tjerët, përfshirë edhe ofrimin ose mbështetjen e kujdesit për fëmijët nga punëdhënësit vendorë.
- (3) Pala Nënshkruese pranon më tej se rritja e fëmijëve kërkon ndarje të përgjegjësive ndërmjet grave dhe burrave dhe të shoqërisë në përgjithësi, dhe merr përsipër të luftojë stereotipet gjinore sipas të cilave kujdesi për fëmijët shihet kryesisht si detyrë ose përgjegjësi e grave.

Neni 17 – Kujdesi për familjarë të tjerë në varësi

- (1) Pala Nënshkruese pranon se gratë dhe burrat kanë përgjegjësi të kujdesen edhe për anëtarë të tjerë jo të mitur të familjes që varen prej tyre, dhe se kjo përgjegjësi mund të ndikojë në aftësinë e tyre për të luajtur një rol të plotë në jetën ekonomike dhe shoqërore.

(2) Pala Nënshkruese po ashtu pranon se këto përgjegjësi të përkujdesit bien shumë më tepër mbi gratë dhe si pasojë, bëhen pengesë për barazinë e grave dhe burrave.

(3) Pala Nënshkruese merr përsipër ta luftojë këtë pabarazi, sipas rastit:

- Duke e bërë përparësi ofrimin dhe promovimin e shërbimeve të përkujdesit me cilësi të lartë dhe të përballueshëm financiarisht për familjarët në varësi, ose drejtpërsëdrejti vetë, ose përmes ofruesve të tjerë;

- Duke ofruar mundësi mbështetjeje dhe promovimi për ata që vuajnë nga izolimi social si rezultat i përgjegjësi të përkujdesit që kanë;

- Duke bërë fushata kundër stereotipit që e merr si të qenë se kujdesi për familjarët në varësi është kryesisht përgjegjësi e grave.

Neni 18 – Përfshirja sociale

(1) Pala Nënshkruese pranon që çdokush ka të drejtën për t'u mbrojtur nga varfëria dhe nga përjashtimi social, dhe për më tepër që gratë, në përgjithësi, kanë më shumë gjasa të vuajnë nga përjashtimi social për shkak se kanë më pak qasje në burime, mallra, shërbime dhe mundësi se sa burrat.

(2) Si rrjedhojë, Pala Nënshkruese merr përsipër që në të gjithë gamën e shërbimeve dhe veprimtarive të veta, dhe duke bashkëpunuar me partnerët e saj socialë, të marrë masa brenda kuadrit të një qasjeje të përgjithshme të bashkërenduar, që:

- Të promovojë qasjen efektive të të gjithë atyre që jetojnë ose që rrezikojnë të jetojnë në një situatë përjashtimi social ose varfërie, në punësim, strehim, formim profesional, arsim, kulturë,

teknologjitë informative dhe të komunikacionit, asistencë sociale dhe mjekësore;

- Të njohë nevojat dhe gjendjen e veçantë të grave që përjetojnë përjashtim social;

- Të promovojë integrimin e grave dhe burrave migrantë, duke marrë parasysh nevojat e tyre specifike.

Neni 19 – Strehimi

(1) Pala Nënshkruese njeh të drejtën e strehimit dhe afirmon që qasja në strehim cilësor përfaqëson një nga nevojat më thelbësore njerëzore, me rëndësi jetësore për mirëqenien e individit dhe të familjes së tij ose të saj.

(2) Pala Nënshkruese po kështu pranon se gratë dhe burrat shpesh kanë nevoja të veçanta dhe të ndryshme nga njëri-tjetri për sa i përket strehimit, të cilat duhet të merren plotësisht parasysh, ndër të cilat edhe fakti që:

(a) Mesatarisht, gratë kanë më pak të ardhura dhe burime se sa burrat, dhe si rrjedhojë kanë nevojë për strehim që mund ta përballojnë financiarisht;

(b) Në shumicën e familjeve me një prind, kryefamiljare janë gratë, çka sjell që ato të kenë si rrjedhim nevoja për qasje në strehim social;

(c) Burrat e cenueshëm shpesh janë të mbi-përfaqësuar ndër personat e pastrehë.

(3) Për këtë arsye, Pala Nënshkruese merr përsipër, sipas rastit:

(a) Të ofrojë ose promovojë qasje në strehim me hapësirë dhe standard të përshtatshëm dhe me mjedis dinjitoz banimi për të gjithë, si dhe me mundësi qasjeje në shërbimet thelbësore;

- (b) Të ndërmarrë hapa për të parandaluar krijimin e të pastrehëve, dhe sidomos për t'u dhënë asistencë të pastrehëve mbi bazën e kriterëve të nevojës, cenueshmërisë dhe mos-diskriminimit;
- (c) Të ndihmojë, në kuadrin e kompetencave të veta, për ta bërë koston e strehimit të arritshme nga ata që nuk kanë burime të mjaftueshme.
- (4) Pala Nënshkruese merr përsipër gjithashtu të sigurojë ose të promovojë të drejta të barabarta të grave dhe burrave për të marrë me qira, për të pasur në pronësi, ose çfarëdo forme tjetër zotërimi, të banesës së tyre dhe gjithashtu, për këtë qëllim, të përdorë kompetencat dhe ndikimin e vet për të siguruar që gratë të kenë qasje të barabartë në huatë hipotekore dhe forma të tjera të asistencës financiare dhe kredisë për qëllime strehimi.
- Të sigurojë, në masë të arsyeshme, që grave dhe burrave, djemve dhe vajzave, t'u ofrohet dhe sigurohet qasje në mjediset dhe veprimtaritë sportive, argëtuese dhe kulturore;
 - Të nxisë gratë dhe burrat, djemtë dhe vajzat, të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në veprimtaritë sportive dhe kulturore, përfshirë edhe ato që tradicionalisht shihen si kryesisht "femërore" ose "mashkullore";
 - Të nxisë artistët dhe shoqatat kulturore dhe sportive të promovojnë veprimtaritë kulturore dhe sportive që i kundërvihen pikëpamjeve stereotipike për gratë dhe burrat;
 - Të nxisë shërbimet e bibliotekave publike t'u kundërvihen stereotipeve gjinore në fondin e librave dhe materialeve të tjera të tyre, si dhe në veprimtaritë e tyre promovionale.

Neni 20 – Kultura, sporti dhe argëtimi

- (1) Pala Nënshkruese njih të drejtën e çdokujt për të marrë pjesë në jetën kulturore të vendit dhe për të shijuar artet.
- (2) Përveç kësaj, Pala Nënshkruese njih rolin që luan sporti duke kontribuar në jetën e komunitetit dhe sigurimin e të drejtave të shëndetit, siç parashikohen në Nenin 14. Ajo gjithashtu pranon se gratë dhe burrat kanë të drejtën e qasjes së barabartë në veprimtaritë dhe institucionet kulturore, argëtuese dhe sportive.
- (3) Pala Nënshkruese pranon që gratë dhe burrat mund të përjetojnë përvoja dhe interesa të ndryshme në lidhje me kulturën, sportet dhe argëtimin dhe se këto mund të jenë rezultat i qëndrimeve dhe veprimeve të stereotipizuara gjinore, dhe për këtë arsye angazhohet të marrë ose promovojë masa, si të jetë e përshtatshme:

Neni 21 – Siguria dhe mbrojtja

- (1) Pala Nënshkruese njih të drejtën e çdo gruaje dhe burri për siguri personale dhe për liri lëvizjeje, dhe se këto të drejta nuk mund të ushtrohen në mënyrë të lirë ose të barabartë nëse gratë ose burrat janë të rrezikuar ose të pasigurtë, qoftë në sferën private ashtu edhe në atë publike, ose nëse ndihen të rrezikuar dhe të pasigurtë.
- (2) Përveç kësaj, Pala Nënshkruese pranon se gratë dhe burrat, pjesërisht për shkak të detyrimeve dhe të stileve të ndryshme të jetesës që kanë, shpesh përballen me probleme të sigurisë dhe mbrojtjes, të cilat duhet të trajtohen.
- (3) Për këtë arsye, Pala Nënshkruese merr përsipër:
- (a) Të analizojë nga këndvështrimi gjinor statistikat që lidhen me vëllimin dhe karakteristikat e

incidenteve (përfshirë edhe krimet e rënda kundër individit) që kanë ndikim në sigurinë dhe mbrojtjen e grave dhe të burrave, dhe, aty ku është e përshtatshme, të masin nivelin dhe natyrën e frikës nga krimi apo nga burime të tjera të pasigurisë;

- (b) Të zhvillojnë dhe zbatojnë strategji, politika dhe veprime, përfshirë edhe përmirësime specifike në gjendjen dhe në mënyrën e projektimit të mjediseve vendore (për shembull, nyjat e transportit, zonat e parkimeve, ndriçimi i rrugëve), ose në ruajtjen e rendit dhe shërbime të tjera të ngjashme, për të shtuar sigurinë dhe mbrojtjen praktike të grave dhe burrave, dhe si përpjekje për të ulur perceptimet e tyre për mungesë sigurie dhe mbrojtjeje.

Neni 22 – Dhuna me bazë gjinore

- (1) Pala Nënshkruese pranon se dhuna me bazë gjinore, që prek në mënyrë disproporcionale gratë, përbën një shkelje të të drejtave themelore të njeriut dhe është sulm ndaj dinjitetit dhe integritetit fizik dhe emocional të qenieve njerëzore.
- (2) Pala Nënshkruese pranon se dhuna me bazë gjinore vjen nga ideja që ka autori i dhunës për superioritetin e njërit seks mbi tjetrin në kontekstin e marrëdhënieve të pabarabarta të pushtetit.
- (3) Për këtë arsye, Pala Nënshkruese merr përsipër të vendosë dhe forcojë politika dhe veprime kundër dhunës me bazë gjinore, që përfshijnë:
- Të ofrojë ose ndihmojë strukturat e posaçme të mbështetjes për viktimat;
 - Të ofrojë informacione publike, në secilën prej gjuhëve kryesore që përdoren në zonën vendore,

për mundësitë e asistencës që ekzistojnë në atë zonë;

- Të sigurojë që personeli profesionist të ketë përgatitjen e duhur për identifikimin dhe mbështetjen e viktimave;
- Të sigurojë ekzistencën e një bashkërendimi efektiv ndërmjet shërbimeve përkatëse, si autoritetet policore, ato të shëndetësisë dhe të strehimit;
- Të nxisin fushata për ngritjen e ndërgjegjësimit dhe programe edukative që u drejtohen viktimave dhe autorëve të mundshëm dhe faktikë të dhunës.

Neni 23 – Trafikimi i qenieve njerëzore

- (1) Pala Nënshkruese pranon se krimi i trafikimit të qenieve njerëzore, që prek në mënyrë disproporcionale gratë, përbën shkelje të të drejtave themelore të njeriut dhe është sulm ndaj dinjitetit dhe integritetit fizik dhe emocional të qenieve njerëzore.
- (2) Pala Nënshkruese merr përsipër të vendosë dhe forcojë politika dhe veprime kundër trafikimit të qenieve njerëzore, ndër të cilat, sipas rrethanave:
- Fushata informuese dhe ndërgjegjësuere;
 - Programe formimi për profesionistët që janë përgjegjës për identifikimin dhe mbështetjen e viktimave.
 - Masa për dekurajimin e kërkesës
 - Masa të përshtatshme në ndihmë të viktimave, ndër të cilat qasje në trajtim mjekësor, strehim të përshtatshëm e të sigurtë, dhe përkthim në gjuhën e tyre.

Planifikimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Neni 24 – Zhvillimi i qëndrueshëm

- (1) Pala Nënshkruese pranon se, në planifikimin dhe hartimin e strategjive për të ardhmen e zonës së saj, duhet të respektohen plotësisht parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, ku përfshihet integrimi i balancuar i përmasave ekonomike, shoqërore, mjedisore dhe kulturore, si dhe, në veçanti, përfshirja e nevojës për promovimin dhe arritjen e barazisë së burrave dhe grave.
- (2) Pala Nënshkruese, si rrjedhojë, merr përsipër të mbajë parasysh parimin e barazisë së burrave dhe grave si një përmasë themelore në të gjitha planifikimet ose hartimet e strategjive të zhvillimit, për një zhvillim të qëndrueshëm të zonës së saj.

Neni 25 – Planifikimi vendor dhe urban

- (1) Pala Nënshkruese pranon rëndësinë e politikave dhe planeve të saj për hapësirat, transportin, zhvillimin ekonomik dhe përdorimin e tokës, në krijimin e kushteve brenda të cilave mund të arrihet në mënyrë më të plotë e drejta e barazisë së grave dhe burrave.
- (2) Pala Nënshkruese merr përsipër të sigurojë që në hartimin, miratimin dhe zbatimin e këtyre politikave dhe planeve:
 - Të mbahet plotësisht parasysh nevoja për promovimin e barazisë efektive në të gjitha aspektet e jetës vendore
 - Të mbahet siç duhet parasysh nevojat specifike të grave dhe burrave, për shembull në lidhje me punësimin, qasjen në shërbime dhe jetën kulturore, arsim dhe përgjegjësi familjare,

mbështetur në të dhënat përkatëse vendore dhe të dhëna të tjera, përfshirë edhe vlerësimet gjinore të bëra nga vetë Pala Nënshkruese

- Të miratohen projekte që ofrojnë zgjidhje cilësore, të cilat mbajnë parasysh nevojat specifike të grave dhe burrave

Neni 26 - Lëvizshmëria dhe transporti

- (1) Pala Nënshkruese pranon se lëvizshmëria dhe qasja në mjetet e transportit janë kushte thelbësore që gratë dhe burrat të jenë në gjendje të ushtrojnë shumë prej të drejtave, detyrave dhe veprimtarive të tyre, ku përfshihen qasja në punësim, arsim, kulturë dhe shërbime thelbësore. Ajo pranon gjithashtu që zhvillimi i qëndrueshëm dhe sukcesi i bashkisë apo rajonit varet në një masë të konsiderueshme nga zhvillimi i një infrastrukture dhe shërbimi të transportit publik efektiv dhe me cilësi të lartë.
- (2) Përveç kësaj, Pala Nënshkruese gjithashtu pranon se burrat dhe gratë shpesh kanë në praktikë nevoja të ndryshme si dhe modele të ndryshme të përdorimit, në lidhje me lëvizshmërinë dhe transportin, në varësi të faktorëve si të ardhurat, përgjegjësitë e përkujdesit ose orët e punës, dhe si rrjedhojë, gratë shpesh përbëjnë pjesën më të madhe të përdoruesve të transportit publik krahasuar me burrat.
- (3) Pala Nënshkruese merr përsipër:
 - (a) Të mbajë parasysh nevojat përkatëse të lëvizshmërisë dhe modelet e përdorimit të transportit, përkatësisht të grave dhe burrave, përfshirë edhe të atyre nga komunitetet urbane dhe rurale;
 - (b) Të sigurojë që shërbimet e transportit që

janë në dispozicion të qytetarëve në zonën e përgjegjesisë së tyre, të ndihmojnë në plotësimin e nevojave specifike dhe të përbashkëta të grave dhe burrave dhe në realizimin e barazisë së vërtetë të grave dhe burrave në jetën vendore.

- (4) Pala Nënshkruese merr përsipër më tej që të promovojë përmirësimet në vijimësi të shërbimeve të transportit publik për zonën e saj, përfshirë lidhjet inter-modale, me qëllim që të trajtohen nevojat specifike dhe të përbashkëta të grave dhe burrave për transport të rregullt, të përballeshëm financiarisht, të sigurtë dhe të aksesueshëm, dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të tyre.

Neni 27 – Zhvillimi ekonomik

- (1) Pala Nënshkruese pranon se arritja e një zhvillimi ekonomik të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm është përbërës me rëndësi jetësore i një bashkie, komune apo rajoni të suksesshëm, dhe se veprimtaritë dhe shërbimet e saj në këtë fushë mund të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në çuarjen përpara e barazisë së grave dhe burrave.
- (2) Pala Nënshkruese njihet nevojën për të shtuar shkallën dhe cilësinë e punësimit të grave dhe po kështu pranon se rreziku i varfërisë, që lidhet me papunësinë afatgjatë dhe punën e paguar, është veçanërisht i lartë për gratë.
- (3) Pala Nënshkruese merr përsipër, në lidhje me veprimtaritë dhe shërbimet e saj në fushën e zhvillimit ekonomik, se do të mbajë plotësisht parasysh nevojat dhe interesat e grave dhe burrave, dhe mundësitë për çuarjen përpara të barazisë ndërmjet tyre, dhe se do të ndërmarrë veprimet e përshtatshme për arritjen e këtij qëllimi. Ndër veprime të tilla janë:

- Dhënia e asistencës për gratë sipërmarrëse;
- Sigurimi i mbështetjes financiare dhe mbështetjeve të tjera për sipërmarrjet, me qëllim nxitjen e barazisë gjinore;
- Nxitjen e stazhiereve femra që të mësojnë aftësi dhe të marrin kualifikime në fusha që tradicionalisht konsiderohen si “për meshkujt” dhe anasjelltas;
- Nxitjen e punëdhënësve që të rekrutojnë stazhiere dhe praktikante femra për ato aftësi, kualifikime, dhe vende pune që tradicionalisht konsiderohen si “për meshkujt” dhe anasjelltas.

Neni 28 – Mjedis

- (1) Pala Nënshkruese njihet përgjegjësinë e saj për të punuar për një nivel më të lartë mbrojtjeje dhe përmirësimi të cilësisë së mjedisit në zonën e saj, ku përfshihen politikat vendore në lidhje me mbeturinat, zhurmën, cilësinë e ajrit, biodiversitetin, dhe ndikimin e ndryshimeve klimatike. Ajo njihet të drejtën e barabartë të grave dhe burrave për të përfituar nga shërbimet dhe politikat e saj në lidhje me mjedisin.
- (2) Pala Nënshkruese pranon se, në shumë vende, stilet e jetesës së grave dhe të burrave janë të ndryshme, dhe se gratë dhe burrat mund të piren të kenë dallime në përdorimin e shërbimeve vendore dhe hapësirave publike dhe të hapura, ose mund të përballen me probleme të ndryshme mjedisore.
- (3) Pala Nënshkruese, në përputhje me këtë, merr përsipër që në hartimin e politikave dhe shërbimeve të saj mjedisore, të mbajë parasysh plotësisht dhe në mënyrë të barabartë, përkatësisht nevojat dhe stilet e veçanta të jetesës së grave dhe burrave, dhe parimet e solidaritetit ndërmjet brezave.

Roli rregullator

Neni 29 – Organet e qeverisjes vendore si organe rregullatore

- (1) Pala Nënshkruese, gjatë kryerjes së detyrave dhe përmbushjes së kompetencave të saj si organ rregullator i veprimtarive përkatëse brenda zonës së saj, njihë rolin e rëndësishëm që ka rregullimi ligjor efektiv dhe mbrojtja e konsumatorit në sigurimin e mirëqenies dhe sigurisë së popullatës së saj vendore, dhe se gratë dhe burrat mund të ndikohen në mënyra të ndryshme nga veprimtaritë përkatëse të rregulluara prej saj.
- (2) Pala Nënshkruese merr përsipër që, në kryerjen e detyrave të saj rregullatore, të mbajë parasysh nevojat, interesat dhe rrethanat e veçanta të grave dhe burrave.

Binjakëzimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

Neni 30

- (1) Pala Nënshkruese njihë vlerën e binjakëzimeve dhe të bashkëpunimeve evropiane dhe ndërkombëtare të organeve të qeverisjes vendore dhe rajonale, për t'i afruar qytetarët e tyre më shumë me njëri-tjetrin, dhe për të promovuar të mësuarit dhe të kuptuarit e ndërsjellë përtej kufijve kombëtarë.
- (2) Pala Nënshkruese merr përsipër që në veprimtaritë e fushave të binjakëzimit dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar:
 - Të përfshijë në këto veprimtari gra dhe burra me prejardhje të ndryshme dhe mbi baza të barabarta;
 - T'i përdorë marrëdhëniet e veta të binjakëzimit dhe partneritetet evropiane dhe ndërkombëtare si platformë për shkëmbimin e përvojave dhe për të mësuarit e ndërsjellë për çështje që lidhen me barazinë e burrave dhe grave;
 - Të përfshijë përmasën e barazisë gjinore në veprimet e saj bashkëpunuese të decentralizuara.

Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve Evropiane (KBRE) është shoqata më e gjerë e organeve vendore dhe rajonale në Evropë.

Ajo ka si anëtarë shoqatat kombëtare të organeve të qeverisjes vendore dhe rajonale nga më se tridhjetë vende evropiane.

Synimi kryesor i KBRE-së është që të promovojë një Evropë të fortë e të bashkuar, mbi bazat e vetë-qeverisjes vendore dhe rajonale dhe demokracisë; një Evropë ku vendimet merren sa më afër qytetarëve që është e mundur, në përputhje me parimin e subsidiaritetit.

Puna e KBRE-së mbulon një gamë të fushash, ndër të cilat shërbimet publike, transporti, politikat rajonale, mjedisi, mundësitë e barabarta ...

KBRE është gjithashtu aktive në fushën ndërkombëtare. Ajo është seksioni evropian i organizatës botërore të qyteteve dhe bashkive, që quhet Bashkimi i Qyteteve dhe Qeverisjeve Vendore, në anglishte United Cities and Local Governments (UCLG)



KARTA EUROPIANE

PËR BARAZI TË GRAVE DHE BURRAVE NË JETËN VENDORE

Një Kartë për organet e qeverisjes vendore dhe rajonale të Evropës që ato të angazhohen të përdorin kompetencat dhe partneritetet e tyre për arritjen e një barazie më të madhe për banorët e tyre

Unë i nënshkruari/e nënshkruara (emri i Nënshkruesit/Nënshkrueses),
titullar/titullare në pozicionin
në..... (emri i organit të qeverisjes vendore/rajonale dhe shteti)

me nënshkrimin tim konfirmoj se autoriteti i sipër-përmendur pajtohet zyrtarisht t'i përmbahet Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, dhe të përmbushë dispozitat e saj, dhe se unë jam zyrtarisht i/e autorizuar të veproj në emër të tij për këtë çështje.

Nënshkrimi
Data

Unë bie dakord t'i dërgoj një kopje të nënshkruar dhe plotësuar të këtij formulari Këshillit të Bashkive dhe rajoneve që është promovuesi i kësaj karte, në adresën e mëposhtme:



Sekretari i Përgjithshëm
Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve
Evropiane
1 Square De Meeûs
B - 1000 Brussels

Bruksel
1, Square De Meeûs
1000 Brussels
tel. : + 32 2 511 74 77
fax : + 32 2 511 09 49

e-mail : info@ccre-cemr.org
www.ccre.org



CEMR falënderon Komisionin Evropian për mbështetjen financiare

Komisioni nuk është përgjegjës për ndonjë përdorim
që mund t'i bëhet informacionit që përmban ky botim